LIGJ
Nr.9238, datë 10.6.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT "REHABILITIMI DHE PAJISJA E 5 POLIKLINIKAVE""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për realizimin e programit "Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4264, datë 8.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR REALIZIMIN E "PROGRAMIT "REHABILITIMI DHE PAJISJA E 5 POLIKLINIKAVE""

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Qeveria e Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim (MAE-DGCS), këtu më poshtë të quajtura "Palë Kontraktuese":

duke u bazuar në protokollin e bashkëpunimit për trevjeçarin 2002-2004, nënshkruar në datën 9 prill 2002, ku kooperacioni italian ka konfirmuar impenjimin financiar për rikonstruksionin e 5 poliklinikave të vendosura në Tiranë (2), Gjirokastër, Peshkopi dhe Korçë, duke destinuar për këtë qëllim një kredi në formë ndihme prej 5 000 000 euro;

Që në vazhdim të sondazhit projektues të bërë nga zyrat kompetente të DGCS-së, Komiteti Drejtues i MAE/DGCS-së ka aprovuar në mbledhjen e datës 29.7.2003 iniciativën: "Rehabilitimi dhe pajisja e 5 poliklinikave", që këtu më poshtë do të quhet "Programi", duke akorduar për këtë qëllim një kredi të butë prej 5 080 000 eurosh dhe një grant (ndihmë) prej 110 000 euro, për të bërë të mundur të gjitha aktivitetet e projektimit, realizimit dhe monitorimit;

Bazuar sa më sipër, Palët Kontraktuese kanë vendosur sa më poshtë:

Neni 1
Qëllimi dhe pjesët e Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë impenjimet reciproke të të dyja palëve për

zbatimin korrekt të programit dhe në mënyrë të veçantë i referohet mënyrës së vlerësimit të kontratave, si dhe menaxhimit/ndërprerjes/dhënies së fondeve të kredisë së butë.

Kjo Marrëveshje është e përbërë nga 14 nene dhe nga 3 shtojcat e mëposhtme, që janë pjesë integrale e saj:

1. Përmbledhje e programit.
2. Prokurimi i shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve (kushtet e veçanta).
3. Mënyra e ekzekutimit dhe menaxhimi i kredisë së butë.

Neni 2

Objektivat e programit

Objektivi i përgjithshëm i programit është që të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të shëndetit të popullsisë përftuese dhe në të njëjtën kohë të përmirësojë kostot e menaxhimit të sistemit shëndetësor.

Objektivi specifik ka qëllim të përmirësojë dhënien e shërbimit shëndetësor në 5 poliklinikat, referuar kualitetit dhe mbulimit të zonës ku do të jepet ky shërbim.

Neni 3

Përshkrimi i programit

Programi është përshkruar në mënyrë të shkurtuar në shtojcën 1 dhe ka qëllim të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- 5 poliklinika të rehabilituara dhe të pajisura;
- shtimin e dhënies së shërbimit me të paktën 50%;
- aktivitete të shëndetit preventiv të përmirësuara dhe uljen e patologjive në sektorin e sëmundjeve të transmetueshme, shëndetin riprodhues dhe pediatri.

Implementimi i programit do të bëhet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme:

- faza projektuese;
- punimet e rehabilitimit fizik dhe impiantet;
- furnizimi i pajisjeve mjekësore, materialet e konsumit dhe trajnimi për përdorimin e mirë dhe mirëmbajtjen.

Neni 4

Institucionet e përfshira në realizimin e programit

Institucionet e përfshira në realizimin e programit janë si më poshtë:

Për Palën Shqiptare:

a) MSH-ja do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që dalin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë strukturat e tjera shqiptare kompetente.

b) Ministria e Financave (MF) që do të nënshkruajë Marrëveshjen financiare me MCC-në dhe që do të kujdeset për kontaktet operative me këtë të fundit dhe me bankat agjente, sipas asaj që do të jetë përcaktuar në Marrëveshjen financiare.

c) PIU i ngritur pranë MSH-së do të kujdeset për koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe menaxhuese të nevojshme për realizimin e programit.

Për Palën Italiane:

a) MAE/DGCS-ja që do të sigurojë lëshimin e fondeve dhe burimeve financiare të kredisë, sipas mënyrave të parashikuara nga normativat italiane në fuqi, që në mënyrë sintetike janë paraqitur në këtë Marrëveshje. MAE/DGCS-ja, në bashkëpunim me MSH-në, do të ketë si detyrë monitorimin e ecurisë së programit, si dhe të ndjekë ecurinë e rezultateve të përcaktuara në nenin 3. MAE/DGCS-ja do të veprojë nëpërmjet zyrave kompetente për kryerjen e detyrave të saj. Në mënyrë të veçantë Zyra Teknike Qendrore e MAE/DGCS-së, këtu më poshtë e quajtur UTC do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike në mbështetje të realizimit të programit.

b) Mediocredito Centrale (MCC), që sipas udhëzimeve të MAE/DGCS-së dhe të Ministrisë së Ekonomisë Italiane do të nënshkruajnë me Ministrinë e Financave Shqiptare një marrëveshje financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë së butë. Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje financiare, MCC-ja do të kujdeset për rregullsinë e secilës kontratë për dhënien e të

mirave materiale, shërbimeve dhe punimeve nëpërmjet të cilave do të realizohen aktivitetet e parashikuara në program. Do të jetë gjithashtu nën kujdesin e MCC-së të sigurojë pagesën e shumave korresponduese kontraktuale të organizmave realizues.

c) Ambasada/UTL (Zyra Teknike Lokale) e Tiranës do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike të nevojshme për supervizionin korrekt të ecurisë së aktiviteteve. Në kuadër të aktiviteteve të saj institucionale, Ambasada/UTL do të sigurojë gjithashtu kontaktet e nevojshme me palën homologe në program, duke u kujdesur nëpërmjet të tjerave për marrjen dhe dërgimin e të gjithë dokumentacionit zyrtar.

Neni 5

Burimet financiare e mënyra e përdorimit të kredisë së butë

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e programit janë si më poshtë:

1. Kredia e butë prej 5 080 000 euro për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në program (projektime, punime, pajisje dhe asistencë teknike/trajnim).

2. Grant 110 000 euro si fond për ekspertët e DGCS-së për aktivitete të asistencës për Ambasadën/UTL dhe për monitorimin periodik të ndërhyrjes.

3. Fondi i Qeverisë shqiptare rreth 500 000 euro për kosto lokale (TVSH, taksa doganore etj.).

Termat dhe kushtet e kredisë së butë janë si më poshtë:

- Periudha e rimbursimit të kredisë 38 vjet
- Periudha e garancisë (për rimbursimin e kredisë) 17 vjet
- Taksa e interesit vjetor 0,10%

Mbi bazën e procedurave në fuqi pranë MAE/DGCS-së, hapat kryesore që duhen ndjekur për përdorimin e fondeve të kredisë së butë janë si më poshtë (më mirë të shpjeguara në shtojcën 3):

1. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

2. Lëshimi nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane i një dekreti ministror që autorizon MCC-në të negociojë dhe të nënshkruajë Marrëveshjen financiare me Ministrinë e Financave.

3. Nënshkrimi i Marrëveshjes financiare midis MCC-së dhe MF-së.

4. Përgatitja e listës së dokumentacionit të garës së prokurimit si më poshtë, e nevojshme kjo e fundit për ekzekutimin e aktiviteteve të parashikuara nga programi:

- për projektimin e punimeve të rehabilitimit civil dhe të impianteve;
- për ekzekutimin e këtyre punimeve;
- për furnizimin e pajisjeve mjekësore.

5. Zhvillimin e këtyre garave të prokurimeve dhe ekzaminimin e ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ngritur nga MSH-ja për zgjedhjen e fituesit.

6. Verifikimin e rregullsisë së procedurave të garave të prokurimit të zhvilluara nga ana MAE/DGCS-së dhe të kontratave që do të lidhen dhe në raste përgjigjesh pozitive lidhjen e kontratave nga ana e MSH-së.

7. Rregullsinë dhe kalimin e kontratave të lidhura, sipas garave, mbi Marrëveshjen financiare me mënyrat e dhënies së fondeve të treguara në shtojcën nr.3.

Neni 6

Monitorimi i programit

Ecuria e programit do të monitorohet në mënyrë të përbashkët nga MAE/DGCS-ja (nëpërmjet misioneve periodike të funksionarëve dhe ekspertëve për këtë qëllim të caktuar) dhe nga MSH-ja. Palët Kontraktuese impenjohen që tani për të përcaktuar të gjitha masat që do të shohin të nevojshme të marrin, në qoftë se gjatë zhvillimit të programit skema e indikatorëve nuk do të respektohet ose, më mirë, nuk do të jetë e përshtashme në lidhje me kushtet sektoriale lokale.

Neni 7

Mënyra e blerjes së shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve

Përcaktimi i ekzekutuesve të aktiviteteve të programit do të bëhet nëpërmjet zhvillimit të garave të disiplinuara nga dispozitat që përmban Manuali i Procedurave (i përdorur nga Komisioni Europian i 23 dhjetorit 2002) që lidhet me: "Prokurimin e shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve në

kuadër të kooperacionit komunitar me vendet e treta", si dhe me sa është sqaruar me shtojcën 2.

Neni 8
Detyrimet e Qeverisë shqiptare

Qeveria shqiptare impenjohet:

- të vërë në dispozicion burimet financiare që i takojnë me vlerë ekujvalente 500 000 euro;
- të bëjë operative të gjitha veprimet, aktivitetet dhe aktet formale të nevojshme për ecurinë e mirë të programit;
- të bashkëpunojë me MAE/DGCS-në për aktivitetet e monitorimit të programit referuar nenit 6 edhe për t'i dhënë akses në dokumentacionin ekzistent dhe në zonat e aktiviteteve.

Neni 9
Detyrimet e Qeverisë italiane

Qeveria italiane impenjohet të garantojë financimet e mëposhtme:

- deri në 5 080 000 euro si kredi e butë, që do të bëhet e disponueshme pranë MCC-së dhe do të disbursohet sipas mënyrave të përcaktuara në shtojcën 3;
- deri në 110 000 euro si dhuratë (grant), që do të menaxhohet direkt nga MAE/DGCS-ja për të asistuar Ambasadën /UTL dhe për aktivitetet e monitorimit.

Neni 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që do të lindë midis Palëve në marrëveshje, në lidhje me interpretimin dhe aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet, për sa është e mundur, nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve.

Neni 11
Pengesat dhe forcat madhore

Në raste pengesash për realizimin e programit, të ardhura për shkak të forcave madhore (luftra, përmbytje, zjarre, tufane, tërmete, konflikte pune, greva, vendime të secilës qeveri, pengesa të paparashikuara në transporte dhe shkaqe të tjera) të njohura nga të dyja Palët ose raste rreziqesh dhe kushte me risk për personelin e huaj do të adoptohen dispozitat e mëposhtme, të bazuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe të aprovuara nga MAE/DGCS-ja:

a) Në qoftë se zgjatja e pengesave për realizimin e programit është më e vogël se 6 muaj, përdorimi i fondeve të paimpenjuara do të bllokohet deri sa MAE/DGCS-ja do të autorizojë rihapjen e aktiviteteve.

b) Në qoftë se zgjatja e pengesave është më e madhe se 6 muaj dhe më e vogël se njëzet e katër, programi ndërpritet dhe fondet e paimpenjuara mbahen deri sa të eliminohet pengesa dhe të vijë autorizimi i MAE-DGCS-së për rifillimin e aktiviteteve.

c) Në qoftë se zgjatja e pengesave do të jetë më e madhe se njëzet e katër muaj, Palët janë të detyruara të bien dakord mbi vazhdimin e programit dhe të caktojnë radhën e veprimeve. Në rast pamundësie për të vazhduar aktivitetet, Palët duhet të vendosin mbi destinacionin e fondeve të paimpenjuara.

Neni 12
E drejta për të zgjidhur Marrëveshjen nga MAE-DGCS-ja

MAE-DGCS-ja rezervon të drejtën për t'u tërhequr nga Marrëveshja në rastet e mëposhtme:

a) Mosrealizimi i aktiviteteve të programit, për shkaqet që nuk mund t'i ngarkohen Palës Italiane.

b) Zgjatje e pengesave ose forcave madhore në bazë të nenit 11.

Në të dyja rastet e përmendura më sipër, MAE-DGCS-ja mund të vendoset në mënyrë të

njëanëshme përfundimin e Marrëveshjes, duke njoftuar MSH-në nëpërmjet një note verbale me të paktën tre muaj paralajmërim. Në çdo rast, pas këtij njoftimi, MSH-ja është e detyruar të ndërpresë aktivitetet e programit, përveç ndonjë marrëveshje tjetër midis Palëve.

Neni 13
Ndryshimet

Palët në Marrëveshje, në çdo moment, mund të propozojnë modifikime për përmbajtjen e Marrëveshjes, nëpërmjet shkëmbimit të notave dhe rrugëve diplomatike. Modifikimet e aprovuara do të hyjnë në fuqi me të njëjtën procedurë të parashikuar nga Marrëveshja për hyrjen e saj fuqi.

Neni 14
Hyrja në fuqi, zgjatja dhe denoncimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë, me të cilën Palët në Marrëveshje do të komunikojnë zyrtarisht kryerjen e procedurave respektive të brendshme, për këtë qëllim të parashikuar.

Kjo Marrëveshje do të jetë trevjeçare dhe e rinovueshme automatikisht për periudha me kohëzgjatje të njëjtë.

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet në çdo moment dhe denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas njoftimit të palës tjetër në Marrëveshje.

Duke besuar se përfaqësuesit për nënshkrim, të autorizuar për këtë nga qeveritë përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë më 17 mars 2004, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe italiane.

Në rast mosmarrëveshjesh në interpretim, do merret për bazë teksti në gjuhën italiane.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË ITALISË
LEONARD SOLIS	ATTILIO MASSIMO IANNUCCI

Shtojca 1

PËRMBLEDHJA E PROGRAMIT

Objektivi

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është i dyfishtë; nga njëra anë kontribuohet për përmirësimin e kushteve të shëndetit të popullsisë përftuese dhe nga ana tjetër tenton të optimizojë kostot e menaxhimit të sistemit.

Si objektiv specifik mendohet të sigurohet një përmirësim i dhënies së shërbimeve shëndetësore të specializuar, duke iu referuar sasisë dhe shtrirjes për të mbuluar një sipërfaqe sa më të madhe të popullsisë në 5 poliklinika, nga të cilat Tirana 2, Tirana 3, poliklinikat e Gjirokastrës, Korcës dhe Peshkopisë, si dhe rritjen e kapaciteteve menaxhuese të drejtuesve shëndetësorë të këtyre rrethve.

Rezultatet e pritshme të këtij programi janë:

- 5 poliklinika të rehabilituara dhe të pajisura.
- Rritja e dhënies së shërbimeve më shumë se 50%.
- Përmirësimi i aktiviteteve mjekësore të parandalimit me ulje të patologjive në fushën e sëmundjeve të transmetueshme, shëndetit riprodhues dhe pediatrisë.

Aktivitetet e parashikuara

Për arritjen e këtyre rezultateve, kjo iniciativë parashikon: (i) fazën e projektimit; (ii) punimet e rehabilitimit të godinave dhe impianteve; (iii) pajisjen e tyre me aparaturë biomedikale diagnostikuese dhe materiale konsumi, formimin e personelit për mirëpërdorimin e tyre dhe mirëmbajtjen.

Për secilën nga këto 5 poliklinika do të ndërhyhet me punime rehabilitimi fizik dhe në impiant në funksion të nevojave të ndryshme që do të ndeshen; bëhet fjalë për ndërhyrje në strukturë, si suvatime dhe veshje muresh të përshtashme për ambiente ambulatore, për ribërjen e impianteve sanitare dhe elektrike. Këto ndërhyrje kanë qëllim të bëjnë ambiente ambulatore, funksionale dhe higjenikisht të përshtashme, në përputhje të plotë me normat e sigurisë për punonjësit e strukturës dhe pacientët.

Në fazën e formulimit është ndjekur një analizë e thelluar për aparaturat e nevojshme dhe funksionale, sipas rolit që ka secila poliklinikë.

Kujdes i veçantë është treguar për të pasur një standard homogjen të aparaturave, duke privilegjuar kualitetin e shërbimit dhe ndërhyrjen e mirëmbajtjes së mundshme në Shqipëri.

Gjithashtu, është parashikuar një kuotë paraprake për materiale konsumi, e llogaritur në 10% të kostos globale të aparaturave.

Kostoja e aparaturave me teknologji më të përparuar se ato që ndodhen prezent aktualisht, është përllogaritur duke marrë parasysh një paketë trajnimi dhe pjesë këmbimi të firmave furnizuese (në fazën e formulimit të kapitullarit, midis kritereve të përzgjedhjes së firmës fituese, do të jepet një pikavarazh specifik për këtë aspekt të trajnimit).

Shpenzimet e përafërta të projektit janë detajuar si më poshtë (të mbuluara nga kredia me terma.

Poliklinika	Rehabilitime (euro)	Pajisje (euro)	Totali (euro)
Gjirokastra	142 400	280 500	422 900
Korça	597 000	651 500	1 248 500
Peshkopia	179 500	460 000	639 500
Tirana 2	446 500	678 000	1 124 500
Tirana 3	666 000	686 000	1 352 000
Nr. totali	2 031 400	2 756 000	4 787 400
Të ndryshme (5%)	101 570	0	0
Totali i pjesshëm	2 132 970	2 756 000	4 888 970
Projektimi	106 649	82 680	189 329
Totali	2 239 619	2 838 680	5 078 299
Totali përfundimtar	2 240 000	2 840 000	5 080 000

Shtojca 2

TENDERIMI I SHËRBIMEVE, PAJISJEVE DHE PUNIMEVE (KUSHTET E VEÇANTA)

Kjo shtojcë i referohet përdorimit të kredisë së butë italiane.

Zgjedhja e firmave do të bëhet nëpërmjet garave të prokurimit të hapura, të rezervuara për shoqërinë italiane. Përqindja e kredisë së butë e harxhuar në vend, në vendet në zhvillim, nuk mund të kalojë 45% të vlerës së vetë kredisë.

Për përcaktimin e të gjitha garave të parashikuara në program, do të adoptohen procedurat e parashikuara në Manualin e Procedurave (të adoptuara nga Komisioni Europian i 23 dhjetorit 2002) për garat e shërbimeve, furnizimin dhe punimet në kuadër të kooperacionit, komunitetit me vendet e treta.

Në çdo rast, procedura e seleksionimit duhet të përfshijë:

1. Verifikimin e besueshmërisë së ofertës (persona juridikë, shoqëri ose ndërmarrje), që nuk do të quhen të besueshme në qoftë se:

a) janë në procedura falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluara ose të konkorduar paraprakisht, të mbylljes së aktivitetit ose që janë objekt i një procedure të ngjashme të parashikuara nga ligjet dhe rregullat kombëtare;

b) janë objekt i një procedure të deklarimit të falimentimit, të likuidimit, të administrimit të kontrolluar, të një marrëveshjeje paraprake ose të një procedure të ngjashme të parashikuar nga ligjet dhe rregullat kombëtare;

c) kanë marrë një dënim të parikuperueshëm për një krim në lidhje me moralitetin profesional;

d) janë përgjegjëse për shkelje të rënda të detyrimeve profesionale, të provuara me çdo lloj

elementi të dokumentuar nga administrata aprovuese e garave;

e) nuk janë në regull me obligimet për kontributet sociale, sipas dispozitave legjislative të vendit në të cilin janë vendosur;

f) nuk janë në rregull me obligimet për taksat dhe detyrimet financiare sipas dispozitave legjislative të vendit në të cilin janë vendosur;

g) janë fajtorë për pasaktësi të rënda në dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata aprovuese e garave në lidhje sa më sipër;

h) janë deklaruar fajtorë, për shkakun se nuk kanë respektuar detyrimet kontratuale, mungesa të rënda në ekzekutimin e punimeve, në kuadër të një kontrate të nënshkruar nga e njëjta administratë aprovuese e garave ose në kuadër të një kontrate të financuar nëpërmjet fondeve të Komunitetit Europian. Si shtesë, ofruesit italianë janë të detyruar të paraqesin një certifikatë ose deklaratë ekuaivalente për mosqenien në kategoritë e përcaktuara nga dekreti legjislativ italian i 8 gushtit 1994, nr.490 *("antimafia").*

Vepruesit duhet gjithashtu të paraqesin, në mbështetje të ofertave tyre, provat e duhura, konform legjislacionii të vendit në të cilin janë vendosur, që të tregojnë se ata nuk ndodhen në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat a, b, c dhe f.

2. Verifikimi i gjendjes ekonomike dhe financiare të ofruesve, nëpërmjet:

a) Deklarimit të kapitalit social të shoqërisë dhe të faturimit në tre vjetët përpara garës.

b) Deklarimin e faturimit total të konkurrentëve dhe, në raste të shoqërive të përkohshme, faturimin e secilit prej pjesëmarrësve.

c) Deklarimin e faturimit në sektorë specifikë të cilëve iu referohet gara ose të sektorit në të cilin, në rastin e shoqërive të përkohshme, shoqëria në mënyrë individuale mendon të kontribuojë.

d) Deklaratë e përshtatshme e përfaqësuesve ligjorë ose një certifikatë bankare, që të përmbajë informacion mbi relacionet me institutet bankare me peshë ndërkombëtare që të demonstrojë besueshmërinë financiare dhe komerciale të konkurruesve dhe të shoqërive që përbëjnë shoqërinë e përkohshme.

e) Një kopje të certifikatës që tregon se konkurrenti është anëtar i dhomës së tregtisë në vendin në të cilin është vendosur.

f) Në rastin e shoqërive të përkohshme, duhet të paraqitet një kopje e kontratës së bashkimit ku të tregohet secila shoqëri do të marrë rolin përgjegjës të përfaqësimit të qëndrueshëm përpara MIE-së në rastin e ekzekutimit të mundshëm të kontratës.

3. Verifikimi i kapacitetit teknik dhe profesional të konkurrentëve nëpërmjet:

a) Kopje të dokumentacionit origjinal që të tregojë ndërtimin ligjor e/ose statutin juridik që përcakton vendin e regjistrimit e/ose zyrën qendrore ose zyrën e regjistrimit dhe, në qoftë se këto nuk përputhen, vendin e zyrës kryesore të shoqërisë ose të bashkëpunimit të zakonshëm, ose të pjesëve të ndryshme të konkurruesve, në rastin e shoqërive të përkohshme.

b) Një raport që të përmbajë dokumente dhe informacione mbi eksperiencat e punës së mëparshme të konkurrentëve dhe në rast shoqërish përkoshme në garat me të njëjtën natyrë në tre vjetët e mëparshëm, dhe gara të tjera në vazhdim me informacione specifike rreth efektivitetit dhe pjesëmarrjes konkrete në çdo garë.

c) Kualifikimet dhe eksperiencën e personave kyç të stafit që do të ngarkohen nga kontraktuesi për ekzekutimin e kontratës.

d) Një raport mbi aktivitetin e konkurruesve, të veçantë ose të bashkuar, vetëm për aktivitetet e lidhura me programin.

Krahasimi ndërmjet konkurruesve, mbi bazën e kritereve të besueshmërisë së përcaktuar në shpalljen e garës është në dosjen e garës, do të bëhet duke përdorur kriteret e përcaktuara dhe çmimin për identifikimin e konkurrentit ekonomikisht më të përshtatshëm. Kriteret duhet të jenë precise, jo diskriminuese, as paragjykuese për një konkurrim korrekt.

Shtojca 3

MËNYRA E EKZEKUTIMIT DHE E MENAXHIMIT TË KREDISË SË BUTË

SEKSIONI 1

SHPALLJA E GARAVE, PROCEDURAT E APLIKUARA

Dokumentacioni i garave duhet të jetë ndërtuar konform shtojcës 2, që i referohet Manualit të Procedurave (të adoptuara nga Komisioni Europian në 23 dhjetor 2002) për garat e shërbimeve, furnizimin dhe punimet në kuadër të kooperacionit të Komunitetit me vendet e treta. Dokumentacioni duhet, në çdo rast:

- të specifikojë "kushtet speciale" për secilën garë;
- të përcaktojë kriteret e vlerësimit që do të përdoren nga komisioni i ndërtuar nga MSH-ja.

1. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

Dokumentacioni i garës për dhënien e shërbimeve të projektimit të punimeve të ristrukturimit fizik dhe impianteve, si dhe specifikimet për pajisjet mjekësore të duhura, do të predispozohen nga Ambasada/UTL (duke përdorur pjesë të financimit grant) dhe do t'i transmetohet PIU-t pranë MSH-së për verifikimet e kompetencës së Palës Shqiptare. Ky dokumentacion garë, i verifikuar ose i integruar nga MSH-ja, do të dërgohet nga PIU pranë Ambasadës/ UTL së bashku me kërkesën për publikimin e lajmërimit të garës në gazetat italiane.

Dokumentacioni i garave për ekzekutimin e punimeve dhe ajo për furnizimin me pajisje mjekësore do të përgatiten nga shoqëria italiane që do të dalë fituese e garës së parë dhe do të verifikohen nga MSH-ja, që do të kujdeset t'ia përciellë Ambasadës/UTL, së bashku me kërkesën për publikimin e lajmërimit të garës në gazetat italiane.

2. Verifikimi i konformitetit të dokumentacionit të garës

Verifikimi i konformitetit me këtë Marrëveshje do të bëhet nga MAE/DGCS-ja dhe do të jetë, në mënyrë të veçantë, mbi këto kritere:

- Përmbajta me karakter ligjor me procedura të shtojcës 2;
- Specifikimet teknike të parametrave të vlerësimit me objektivat që programi propozon të arrijë;

- Publikimi i lajmërimit.

Në rastin e aprovimit, lajmërimet e garave do të bëhen rast pas rasti nga MAE/DGCS-ja, në gazetat italiane, në Buletinin e Kooperacionit dhe në faqen WEB të MAE-së, MSH-së do të vazhdojë në të njëjtën mënyrë të publikojë lajmërimin në gazetat kombëtare.

SEKSIONI 2
FAZA E VLERËSIMIT-PROCEDURA E APLIKUAR

1. Ekzaminimi i oferatve të ardhura do të bëhet nga një komision vlerësimi i ngritur për këtë qëllim nga MSH-ja. PIU-n pranë MSH-së do të ndjekë ecurinë e garave, duke asistuar aty ku është i nevojshëm komisioni. Në çdo rast, në mbledhjet e komisionit nuk mund të marrë pjesë personel italian që punon pranë Ambasadës/UTL se më mirë i dërguar në mision nga DGCS-ja.

2. PIU do t'i dërgojë Ambasadës/UTL dokumentacionin që përmban aktet e komisionit, vetëm për kontratat që do të lidhen, duke kërkuar aprovimin për firmosjen e tyre. Ky dokumentacion do të dërgohet nga Ambasada/UTL pranë MAE/DGCD-së me komentet e mundshme.

3. MAE/DGCS-ja do të verifikojë kryesisht përputhjen ligjore dhe teknike të vlerësimit të kryer me procedurën dhe kriteret/parametrat e parashikuara në secilin dokumentacion garë. Pas kompletimit të verifikimit, MAE/DGCS-ja do të informojë PIU-n, nëpërmjet Ambasadës/UTL, për përgjigjen e tij.

4. Në rast përgjigje pozitive *(aprovim)*, MSH-ja do të procedojë me firmosjen e kontratës me shoqërinë që do të jetë fituese.

SEKSIONI 3
FAZA E KALIMIT TË KONTRATAVE DHE E LËSHIMIT TË FONDEVE-PROCEDURAT E APLIKUARA

1. Kontrata rast pas rasti të nënshkruara midis shoqërive italiane dhe MSH-së duhet të dërgohen te MAE/DGCS-ja nëpërmjet Ambasadës/UTL, bashkëlidhur me kopjen *performancë bond*,

me deklarimin e impenjimit të Palës Shqiptare për të përballuar kostot lokale (TVSH, taksa doganale, shpronësime, etj).

2. Pas marrjes dhe ekzaminimit të këtij dokumentacioni, MAE/DGCS-ja do të kujdeset që të autorizojë Mediocredito Centrale të kalojë çdo kontratë të veçantë në Konventën financiare.

3. Mediocredito Centrale do të kërkojë nga shoqëria italiane e interesuar një *"dekleratë impenjimi"* që materialet dhe shërbimet të jenë me origjinë italiane dhe që shpenzimet që do të përballohen në vend ose në vende të treta nuk mund të kalojnë 45% të vlerës së kontratës, si dhe një certifikatë antimafia. Në të njëjtën mënyrë, Mediocredito Centrale do t'i kërkojë kredituesit shqiptar dërgimin e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve dhe letrën për bankën agjente.

Pas marrjes në dispozicion të të gjithë dokumentacionit sipas pikës 3, Mediocredito Centrale do t'i komunikojë kredituesit, bankës agjente italiane dhe PIU-t pranë MSH-së, kalimin e kontratës në Konventën financiare dhe financueshmërinë e saj.

Kompletimi i kësaj procedure do të lejojë lëshimin e paradhënies së pagesës, aty ku kjo është parashikuar nga kontratat dhe do të përcaktojë datën efektive të hyrjes në fuqi të vetë kontratës.

Përsa i përket të gjitha pagesave të tjera, ato mund të bëhen vetëm pas aprovimit për kryerjen e plotë të punimeve/shërbimeve nga ana e MSH-së, sipas asaj që është përcaktuar në kontratë.